

**RREGULLORE  
PËR KRITERET E DHËNIES DHE HEQJES SË STATUSIT TË KLIENTIT TË  
KUALIFIKUAR**

**Miratuar me Vendim te Bordit te Komisionereve  
Nr.99, datë 27.12.2006 te ndryshuar me vendimin nr.17 date 06.03.2009**

**KAPITULLI I PARË  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1  
**Qëllimi i rregullores**

Kjo rregullore hartohet në përputhje me ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neni 48, të ndryshuar dhe ka për qëllim vendosjen e rregullave për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar.

Neni 2  
**Zbatimi**

Kjo rregullore zbatohet për të gjithë **subjektet**, që përfitojnë statusin e klientit të kualifikuar sipas nenit 48 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe sipas kësaj rregulloreje.

Neni 3  
**Përkufizime**

Në këtë rregullore termat e përdorur më poshtë do të kenë kuptimin:

1. “ERE” do të thotë **Enti Rregullator i Energjisë**.
2. “Bordi i Komisionerëve” është organi vendimmarrës i ERE-s i përbërë nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të legjislationit në fuqi.
3. “Furnizues i kualifikuar” është personi i licencuar për të furnizuar një ose më shumë klientë të kualifikuar.  
**3/1. Subjekt** – Ne kuptim te kesaj rregullore do te thote nje person fizik ose juridik qe kerkon te perfitoje statusin e klientit te kualifikuar.
4. “Klientë i kualifikuar” është klienti që ka të drejtë të zgjedhë, për nevojat e tij vetjake, furnizuesin e energjisë elektrike.
5. “**OSSH** ” është personi i licencuar për të kryer veprimtarine e shpërndarjes se energjisë elektrike dhe ate te furnizimit publik me pakice
6. **OST** është personi i licencuar për të kryer veprimtaritë e transmetimit të energjisë elektrike, dispeçerimit të sistemit elektroenergjetik, si dhe për operimin e tregut të energjisë elektrike.
7. “**Klienti tarifor**” është klienti, që furnizohet nga furnizuesi publik me çmime dhe tarifa të rregulluara. (shfuqizuar)
9. “Nivel i konsumit vjetor” sasia e energjisë elektrike që një klient duhet të konsumojë gjatë një viti, e përcaktuar nga Bordi i Komisionerëve brenda muajit janar të çdo viti.

KAPITULLI I DYTË  
KRITERET DHE PROCEDURAT PËR DHËNIEN E STATUSIT TË KLIENTIT TË  
KUALIFIKUAR

Neni 4

**Kriteret për dhënie e statusit**

**Ka të drejtë të kërkojë statusin e klientit të kualifikuar subjekti që plotëson kërkesen e kësaj rregulloreje si më poshtë:**

**a) Paraqet në ERE nje kerkese me shkrim per te perfituar statusin e klientit te kualifikuar si dhe kopje të noterizuar te nje dokumenti te leshuar nga furnizuesi i meparshem ku cilesohet dhe konfirmohet pagesa e te gjithe detyrimeve per energjise elektrike qe subjekti(aplikusi) ka konsumuar deri ne momentin e aplikimit**

Neni 5

**Regjistrimi i kërkesës dhe vendimi i Bordit**

**1. Çdo subjekt egsisutes apo i prespektives,** që plotëson kriterin e përcaktuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje, duhet të njoftoje me shkrim dhe OSSH per kerkesen e paraqitur ne ERE, së cilës i bashkëngjit dokumentin që provon plotësimin e kriterit për përfitim e statusit te Klientit te Kualifikuar.

**2. Kerkesa paraqitet 90 dite perpara per te perfituar statusin .**

**2. Brenda 30 diteve nga marrja e kerkeses, Bordi pasi konstaton rregullshmerine e aplikimit, vendos per dhenien ose jo te statusit te klientit te kualifikuar si dhe si dhe afatin kur statusi behet efektiv**

Neni 6

**Bërja efektive e statusit**

- 1. Pas marrjes se vendimit te Bordit te Komisionereve per dhenien e statusit të klientit të kualifikuar, klienti duhet të njoftojë te pakten 60 ditë përpara bërjes efektive të statusit, OSSH apo OST.**
- 2. Mbas afatit te percaktuar nga Bordi i Komisionere per statusin e klientit te kualifikuar, klienti e humbet statusin e klientit tarifor dhe Furnizuesi Publik me Pakice nuk do ta furnizoje me energji elektrike kete kliente.**
- 3. Klienti i kualifikuar, mund të lidhë kontratë për furnizimin me energji elektrike me çdo furnizues të kualifikuar,**

KAPITULLI I TRETË  
KRITERET DHE PROCEDURAT PËR HEQJEN E STATUSIT TË KLIENTIT TË  
KUALIFIKUAR

Neni 7

**Heqja e statusit të klientit të kualifikuar**

Statusi i klientit të kualifikuar hiqet kur:

- a) klienti deklaron se heq dorë nga statusi i dhënë;
- b) nuk zbaton legjislacionin në fuqi.

Neni 8

### **Heqja e statusit me kërkesë të klientit të kualifikuar**

1. Në rastet kur klienti i kualifikuar kërkon që të hiqet ky status, për tu konsideruar si klient tarifor, duhet të bëjë kërkesë me shkrim pranë ERE-s për heqjen e statusit të Klientit të Kualifikuar, **brenda 90 ditëve nga data nga të cilën ai kërkon të kthehet në kliente tarifore. Për këtë ai njofton edhe OSSH**, për kërkesën e mesipërme.
  2. Para vendimmarrjes ERE-ja do të marrë opinionin e OSSH dhe KESH ( F.P.SH ) për këtë kërkesë.
  3. ERE do të marrë informacion nga Furnizuesi i Kualifikuar me të cilin aplikusi ka patur kontratë furnizimi me energji elektrike gjatë kohës që gezonte statusin e klientit të kualifikuar.
  4. ERE nëse e gjykon të arsyeshme mund të aplikojë një shtesë cmimi për këtë rikthim.
2. ERE do të marrë vendim për heqjen e statusit brenda 30 ditëve nga dita e regjistrimit në ERE të kërkesës së klientit të kualifikuar për t'u kthyer në klient tarifor.
3. Brenda 5 ditëve pune nga marrja e vendimit për heqjen e statusit të klientit të kualifikuar, ERE njofton OSSH dhe ose OST për vendimin e saj.

## **KAPITULLI I KATËRT DISPOZITA TË FUNDIT**

Neni 10

### **Lidhja e kontratës së furnizimit me energji elektrike me OSSH/FPP**

Brenda 30 ditëve nga vendimi i Bordit të Komisionerëve, klienti që është kthyer në klient tarifor sipas vendimit të ERE-s në zbatim të procedurave të mesipërme, OSSH/FPP detyrohet të lidhë kontratën e furnizimit me energji elektrike me klientin sipas modelit të kontratës së miratuar nga ERE për furnizimin me energji elektrike të klientëve tariforë me cmimin e miratuar nga Bordi i Komisionerëve.

Neni 12

### **Ndryshimi i rregullores**

Kjo rregullore është objekt rishikimi, me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, sipas rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s.

Neni 13

### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.